

STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJSI TË KUFIZUAR

“SEGRAMO”

NENI 1

1.1 Shoqëria me përgjegjsi të kufizuar “SEGRAMO” shpk është themeluar nga ortaku i vetem:

Gramoz SEJATI I biri I Rafetit, datelindja 10.05.1969, lindur ne Erseke dhe banues ne Korce me Dokument nr. 027752108.

Themeluesit në përputhje me ligjin hartojnë dhe Statutin e Shoqërisë si më poshtë:

EMËRTIMI I SHOQËRISË

1.2 Emërtimi i shoqërisë është “SEGRAMO” shpk.

NENI 2

2.1 Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë vecanërisht sipas ligjit 9901 dt 14.04.2008, “ Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” dhe Ligji nr.129/2014 dt 02.10.2014 për disa shtesa dhe ndryshime të Ligjit 9901 dt 14.04.2008, “ Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 3


FORMA

3.1 Shoqëria “SEGRAMO” shpk, është “Shoqëri me Përgjegjsi të Kufizuar” Sh.p.k.

NENI 4

4.1 Selia e shoqërisë “SEGRAMO” shpk do të jetë , ne Korçë, ne adresen: Lagja nr.7, Rruga 28 Nentori, Pallati 2, hyrja 2, apartamenti nr.2 Korce.

NENI 5



OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

5.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Tregeti me shumice dhe pakice te te gjitha materialeve industriale, elektrike, paisje televizive, elektro shtepiake, ndertimore, ushqimore, bujqesore e blegtorale, etj.
- Import dhe eksport te te gjitha materialeve industriale, elektrike, paisje televizive, elektro shtepiake, ndertimore, ushqimore, bujqesore e blegtorale etj.
- Transport mallrash te gjitha llojeve, dhe pasagjeresh, brenda dhe jashte vendit.
- Punime e sherbime te llojeve te ndryshme, etj.

NENI 6

6.1 Kohë zgjatja e kësaj shoqerie do të jetë pa afat dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimit në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

NENI 7

7.1 Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të kryejë e te transferojë, apo të suprimojë qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

NENI 8

KAPIALI I SHOQËRISË DHE PJESËT

8.1 Kapitali I shoqërisë ka vlerë 100,000 lek i cili ndahet ne 1 kuote. Vlera e kapitali të shoqërisë është Tërësish e rimbursueshme me kontributin e otakëve sipas raportit të ortakëve.

8.2 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Asamblesë te Përgjithshme të otakëve. Në rast zmadhimi të kapitalit orakët kanë të drejtë e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.

8.3 Kapitali i shoqërisë mund të zvogelohet me vendim të Asamblesë te Përgjithshme të otakëve.

NENI 9

KONTRIBUTET

9.1 Kapitali I shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetem i shoqërisë "SEGRAMO" shpk si vijon;

Ortaku z. Gramoz Sejati zotëron një kuotë të barabartë me 100% të të gjithe vlerës së kapitalit, me vlerë totale prej 100,000 lek.


NENI 10

Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit:

10.1 Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë, n.q.s Asamblea e miraton.

NENI 11

Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.



Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjsi të kufizuar.

NENI 12 ORGANET E SHOQËRISË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

12.1 Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit që ai zotëron.

12.2 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

12.3 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

12.4 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

12.5 Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertët kontabël të autorizuar, po qe se ka të tillë, nga likuiduesit apo ortakët e shoqërisë, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Këta ortakë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbarë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës.


12.6 Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbarë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

12.7 Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi “ Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

12.8 Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme bëhet nga administratorët.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjse për to:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;



i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Sipas rëndësisë së vendimeve asambleja mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, si emërtimi apo shkarkimi I ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi I raporteve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore asambleja e zakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave dhe vendimet Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, meren me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrësve.

Asambleja e Jashtëzakonshme mer vendime si për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, marrja e vendimeve mund të bëhet vetëm nëse janë të pranishëm të dy ortakët.

Statuti mund të parashikojë për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me një të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Nëse asambleja nuk mblidhet për shkak të mungesës së uoromit të lartpërmendur ajo mund të mblidhet sërisht jo më vonë se 30 ditë, në të njëtin rend dite.

NENI 13

ADMINISTRIMI

13.1 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator të zgjedhur brenda bashkësisë së orakëve ose jashtë saj, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

13.2 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë dhe emërojë administratorin sipas parashikimit në statut.

13.3 Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- f) të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme;
- g) administrojnë bashkërisht dhe vec e vec shoqërinë
- h) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkoje administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

NENI 15

EMËRIMI I PARË I ADMINISTRATORËVE

Administratori i parë për shoqërinë për periudhën SEGRAMO emërohet :

Gramoz SEJATI I biri I Rafetit, datelindja 10.05.1969, lindur ne Erseke dhe banues ne Korce me Dokument nr. 027752108. Afati i tij i emerimit eshte per 5 (pesë) vjet, qe nga dita e regjistrimit te Shoqerise.

NENI 16

16.1 Për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë së mësipërme, për të cilën nevojitet leje përkatëse, shoqeria është e detyruar të pajiset paraprakisht me këtë leje nga organi kompetent.

NENI 17

17.1 Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli kryhet nga ekspert kontabël i autorizuar, I emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhje nga Asambleja e Zakonshme.

17.2 Shkarkimi I ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërtimi I tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

NENI 18

18.1 Cdo Vit finanziar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

NENI 19

LLOGARITË VJETORE

19.1 Të gjitha llogaritë vjetore,inventari,raportet mbi operacionet e vitit finansiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar,miratohen nga asambleja e zakonshme.

19.2 Miratimi behet Brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e mbylljes së vitit finansiar.

NENI 20 DIVIDENTËT

20.1 Pas miratimit të llogaritjeve vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve , Asambleja e ortakëve përcakton pjesën që u takon ortakëve në porporcion me përqindjen e pjesmarrjes së gjithsecilit në shoqëri.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

NENI 21 PRISHJA E SHOQËRISË

21.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj,me vendim të asamblesë së përgjithshme ose për arsyet e tjera, të parashikuara në ligj.

21.2 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk prishet kur falimenton një prej ortakëve,bëhet I paaftë apo vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjetrë që kanë mbetur si trashëgimtarë apo pasardhës të ortakut që vdes.

NENI 22 LIKUJDIMI

22.2 Likujdimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

Ortaket do te percaktojne menyrat e likujdimit te shoqerise dhe do te caktojne një ose me shume likujdatore duke i percaktuar dhe detyrat konkrete.

Likujdatoret kujdesen qe ne rradhe te pare te shlyejne detyrimet qe ka shoqeria ndaj personave te trete.


Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete statut do ti referohen plotesimeve qe mund te bejne ortaket, si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

NENI 23

23.1 Shndërimi i shoqërisë me përgjegjsi të kufizuar në një lloj tjeter shoqërie mund të kryhet vetëm me vendim unanim të ortakëve.

NENI 24

24.1 Të gjitha mosmarëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë apo përgajtë



periudhës së likujdimit midis ortakëve , ndërmjet shoqërisë dhe orakëve do ti parqiten për zgjidhje Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Korce.

NENI 25

Për cështje që nuk janë parashikuar në statut do të zbatohet legjislacioni në fuqi “ Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”.

Ky raport nënshkruhet nga themeluesit.

ORTAKU I VETEM

GRAMOZ SEJATI

Dt 25/09/2014